


## Projekti Hidroenergjetik i Devollit

Devoll Hydropower Sh.A. (DHP) është një kompani e regjistruar në Shqipëri, nën pronësi dhe e operuar prej kompanisë norvegjeze Statkraft AS.

Qeveria shqiptare, me anën e një tenderi të hapur ndërombëtar, ka caktuar fitues DHP të një koncesioni BOOT (Build - Ndërtim, Own - Pronësi, Operate - Operim dhe Transfer - Transferim). Qëllimi i këtij koncesioni është zhvillimi i hidrocentraleve në Luginën e Lumit Devoll, i cili ndodhet në pjesën jug-lindore të Shqipërisë. Marrëveshja e Koncesionit është ratifikuar nga Parlamenti Shqiptar dhe ka hyrë në fuqi më 1 prill 2009.

Kapaciteti total i instaluar i këtij projekti do të jetë prej rreth 280 MW, kur të përfundojë ndërtimi në vitin 2019.



## Angazhimi i DHP-së

Përgjegjësitë mjedisore dhe sociale konsiderohen pjesë integrale e zhvillimit të projektit.

DHP është e angazhuar të arrijë një ekuilibër midis faktorëve ekonomikë, mjedisor dhe socialë në të gjitha aktivitetet që kryen.

## Kontakte

### DEVOLL HYDROPOWER SH.A.

**Qendra e Informimit të Publikut e DHP-së Gramsh**  
Lagjia Holta, Gramsh, Shqipëri

**Zyra e Informimit të Publikut e DHP-së Nikollarë**  
Fshati Nikollarë, Komuna Moglicë, Korçë, Shqipëri

**Zyra e Informimit të Publikut e DHP-së Banjë**  
Fshati Shtepanj, Komuna Gostimë, Elbasan, Shqipëri

### Personat e kontaktit rreth MSHA:

**Z. Alban Avdiu**  
**Z. Ervin Dedja**  
Tel.: +355 (0) 4 450 1301

**Znj. Erma Çekrezi**  
Tel.: +355 (0) 4 450 1310

e-mail: [grievance@devollhydropower.al](mailto:grievance@devollhydropower.al)

web: [www.devollhydropower.al](http://www.devollhydropower.al)

### DEVOLL HYDROPOWER SH.A.

ABA Business Centre  
Zyra Nr. 1204  
Rruga Papa Gjon Pali II,  
Tiranë,  
Shqipëri

Statkraft është lider në tregun e energjive të rinovueshme në Europë. Statkraft zhvillon projekte për gjenerimin e energjisë nga uji, era, dielli, ngrohja qendrore dhe është një lojtar i rëndësishëm në bursën e shkëmbimit të energjisë në tregun European. Statkraft ka më shumë se 3.200 të punësuar në më shumë se 20 vende.

# PROJEKTI HIDROENERGJETIK I DEVOLLIT

## FLETËPALOSJA E MEKANIZMIT TË SHQYRTIMIT TË ANKESAVE

SHTATOR 2013

## Mekanizmi i Shqyrtimit të Ankesave

DHP ka krijuar një Mekanizëm Shqyrtimi Ankesash (MShA). Kjo është bërë për t'u siguruar se kushdo që ka ndonjë ankesë apo shqetësim rreth aktiviteteve të Projektit të DHP-së, të mund të na informojë dhe të mund të ketë një përgjigje nga ana jonë për mënyrën se si kompania do ta adresojë këtë shqetësim apo çështje. Procedura është e aplikueshme për aktivitetet e kaluara dhe ato aktuale të projektit.

Ky mekanizëm është krijuar duke njohur rëndësinë e transparencës dhe përgjegjësisë. Shqetësimet dhe ankesat e personave të prekur nga projekti dhe palëve të tjera të interesuara mund të bëhen lirish, dhe do të adresohen në një mënyrë të drejtë, objektive dhe konstruktive.

DHP do të analizojë të gjitha ankesat e dorëzuara. Nëse DHP konstaton se një ankesë nuk është e lidhur me aktivitetet e DHP-së apo nëse Projekti është në përputhje me Standardet Shqiptare dhe ato Ndërkombëtare për të cilat DHP është e angazhuar, ne do jua shpjegojmë këtë me shkrim. Nëse DHP konstaton se subjekti i ankesës është rezultat i aktiviteteve të DHP-së dhe nuk përputhet me angazhimet Mjedisore dhe Sociale të DHP-së, ne do ta shqyrtojmë çështjen dhe do ju kontaktojmë për t'ju sugjeruar dhe rënë dakord në një zgjidhje të përshtatshme.

DHP do ta trajtojë ankesën tuaj në mënyrë konfidenciale.



## Raportimi i një Ankesë

Mund të na raportoni një ankesë nëpërmjet:

- Vizitës në Zyrat tona të Informimit të Publikut në Gramsh, Banjë dhe Nikollarë dhe plotësimin të një Formulari Ankesë
- Dërgimit të një letre në zyrat tona
- Kontaktoni me DHP-në personalisht, me email apo në telefon

Ne do ju kontaktojmë për t'ju dhënë një përgjigje.

## Hapat Kryesore të Mekanizmit

### 1. REGJISTRIMI I ANKESAVE

Kur ne të regjistrujmë Ankesën tuaj, do ta procesojmë atë. Ankesat duhet të jenë me shkrim. Nëse ju do të na njoftoni verbalisht për ankesën tuaj duke ardhur te një nga Qendrat tona të Informimit, ne do ju ndihmojmë në plotësimin e formës. Pas regjistrimit, Ankesa juaj do të procesohet nëpërmjet Mekanizmit të Shqyrtimit të Ankesave.

### 2. PRANIMI I ANKESËS

Ankesa juaj do të pranohet me shkrim brenda 15 ditësh. Kjo kryhet për t'ju confirmuar se Ankesa juaj është regjistruar dhe po procesohet nëpërmjet Mekanizmit të Shqyrtimit të Ankesave. Pranimi do ju informojë edhe për numrin e ankesës, personin e kontaktit, procesin dhe një afat të përafërt për zgjidhjen e ankesës.

### 3. ZGJIDHJA E ANKESËS

Njësitë / Komitetet e caktuara të DHP-së do të shqyrtojnë ankesën tuaj. Brenda 30 ditësh të njohjes së ankesës tuaj ne do ju kontaktojmë për t'ju dhënë zgjidhjen tonë apo për t'ju përditësuar me statusin e ankesës.

### 4A. APELIMI

Nëse ju nuk jeni të kënaqur me zgjidhjen e propozuar nga DHP, keni mundësinë e apelimit për rishikim të çështjes nga DHP. Ankesa mund të transferohet lirish në ndonjë nivel tjetër alternativ shqyrtimi jashtë DHP-së.

### 4B. MARRËVESHJA

Nëse ju jeni i kënaqur me shqyrtimin e bërë dhe zgjidhjen e propozuar nga DHP-ja, ne do ju kërkohet të firmosni një deklaratë marrëveshjeje për këtë gjë. Kjo shërben për të formalizuar veprimet korrigjuese për t'u zbatuar nga DHP për zgjidhjen e Ankesës.

### 5. ZBATIMI I ZGJIDHJES

Pas arritjes së marrëveshjes për zgjidhjen e ankesës DHP do të zbatojë veprimet korrigjuese të rëna dakord.

## Ankesa që Mund të Ngrini

Ju mund të ngrini një ankesë apo shqetësim në DHP nëse ju besoni se Projekti ka pasur apo ka një ndikim negativ në ju apo në familjen tuaj.

### SHEMBUJ TË ANKESAVE MUND TË PËRFSHIJNË, POR NUK KUFIZOHEN NË:

- Pasojat e projektit apo aktivitetet e tij ndikojnë negativisht jetën tuaj të përditshme
- Efekte negative te një person, shtëpi apo grup komuniteti (p.sh. humbje financiare, humbje e burimeve, dëmtim fizik)
- Aktivitet kriminal
- Shpërdorim apo shkelje financiare
- Përpjekje për të fshehur ndonjë nga më të mësipërmet

